



**Komisioni për mbajtjen e dëgjimeve publike për kornizën afatmesme buxhetore dhe qarkoren buxhetore të komunës së Suharekës për vitin 2027-2029**

## **PROCESVERBAL**

### **MBI MBAJTJEN E DËGJIMIT PUBLIK ME QYTETARË**

I mbajtur më datë 20/05/2026, në SHFMU “Vaso Pashë Shkodrani” në fshatin Leshan, me banorët e fshatrave Leshan dhe Tërrnje, Komuna e Suharekës.

#### **1. Baza Ligjore**

**Ky dëgjim publik është mbajtur në bazë të:**

- Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 124, që garanton pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen lokale;
- Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Statutit të Komunës së Suharekës;
- Dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin e dëgjimeve publike.

#### **2. Të Pranishmit**

Në këtë dëgjim publik morën pjesë përfaqësues të komunës, përfaqësues të fshatit dhe qytetarë të interesuar.

- Përfaqësuesi i Komunës: Anëtarët e Komisionit – Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe Shqipron Bytyçi (Procesmbajtës)
- Banorë të fshatit Leshan dhe Tërrnje, gjithsej pjesmarrës **11 qytetarë**  
Meshkuj **11**  
Femra **0**

#### **3. Rend Dite**

1. Hapja e takimit dhe prezantimi i pjesëmarrësve;
2. Prezantimi i projekteve dhe planifikimeve komunale;

3. Diskutimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve;
4. Pyetje, komente dhe rekomandime nga qytetarët;
5. Përmbyllja e takimit.

#### **4. Përmbledhje e Diskutimeve**

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët paraqitën kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e tyre lidhur me infrastrukturën lokale, rrugët, ndriçimin publik, furnizimin me ujë, kanalizimin, shërbimet komunale, arsimin dhe çështje tjera me interes publik.

Përfaqësuesit e komunës dhanë sqarime lidhur me projektet aktuale dhe planifikimet për periudhën e ardhshme, duke u zotuar që kërkesat e qytetarëve do të shqyrtohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore të komunës.

Kërkesat e qytetarëve prezent në këtë Dëgjim Publik:

- 1. Idriz Voci – qytetar nga fshati Tërrnje** shprehi ankesa lidhur me projektet infrastukurore në fshatin Tërrnje, po ashtu kërkoi që të rritet shuma e paraparë investive prej 10000 Eurosh në Fshatin Tërrnje, kërkesë tjetër e tij ishte rregullimi i rrugës “Martirët e Tërrnjes” në gjatësi të përafërt prej 1 km, po ashtu rregullimin e parkingut tek varrezat e fshatit, rregullimin e rrugës “Flakadani” me gjatësi të përafërt prej 100 metra, ndriçimin publik të fshatit, si dhe rregullimin e rrugëve fushore.
- 2. Shaqir Kryeziu – qytetar nga fshati Leshan** kërkoi tu jepet përparësi rrugëve kryesore para atyre dytësore

#### **5. Konkluzionet dhe Rekomandimet**

- Të evidentohen kërkesat prioritare të qytetarëve;
- Të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së projekteve në planifikimin buxhetor komunal;
- Të vazhdohet organizimi i dëgjimeve publike në të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës;
- Të njoftohen qytetarët për realizimin e rekomandimeve dhe projekteve të planifikuara.

## 6. Përmbyllja

Takimi përfundoi në ora 18:50. Ky procesverbal u hartua për nevoja administrative dhe evidencë zyrtare të komunës.

*Pjesë integrale e këtij procesverbalit është po ashtu dhe Lista e Pjesëmarrjes, me evidencën e pjesëmarrësve.*

Hartuesi i Procesverbalit
---------------------------





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREK



Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në LESHTAN DHE TËRRNJË

Data: 20/05/2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	lorie Voci	TËRRNJË	
2	Fajim Gashi	leshane	Gashi
3	Agnon Bytyqi	Leshtan	
4	Enver Shabani	Tërrnje	
5	SKENXA AVOGGI	LESHTAN	Smw
6	XHEVAT GASHI	LESHTAN	
7	Maim Gashi	LESHTAN	
8	XHEVAT KAPATINCA	TERRNJE	
9	KADRI BUZHATCA	leshane	
10	Shaqir Lijerri	leshane	
11	GAJIM GASHI	LESHTAN	
12			
13			